



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA FINIQ

Data \_\_\_/\_\_\_/ 2024

### PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

#### PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

##### **OBJEKTI I PROKURIMIT:**

“REHABILITIMI I SHKARKUESIT KATASTROFIK TË DIGËS SË REZERVUARIT KARROQ”

##### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

45247270-3 PUNIME NDËRTIMI PËR REZERVUARË

50514200-3 SHËRBIME PËR RIPARIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E REZERVUARËVE

##### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

22 364 393 (NJËZET E DY MILION E TRE QIND E GJASHTËDHJETË E KATËR MIJË E TRE QIND E NËNTËDHJETË E TRE ) LEKË PA TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar njesia e prokurimit prane autoritetit/entit kontraktor **Bashkia Finiq** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit të kontratës/marrëveshjes kuadër..

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin

*kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është "e hapur", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është ne nenin 43, pika 1" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet se: "Autoriteti /entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

**Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:**

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9 dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktoje saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me faturat tatimore të shitjes, ku të shënohen datat, shumat, natyra e punës së kryer dhe situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

*Pika 2.3.1 germa “a” plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*

*Kurse pika 2.3.1 germa “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).*

*Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që kamarrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.*

*Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

N.P. -1 A Punime gërmimi në tokë.

N.P.-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

## PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S- 9 A Punime strukturore speciale.

N.S.-18 A Punime topogjeodezike.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të dorezoje licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në baze të marrëveshjes së bashkepunimit merr përsiper të realizoje.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

*(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Sipas preventivit- Germim shkambi mesatar	A	0-20 milion

		me çekiç me ekskavator me zinxhir ( per hapjen dhe skarifikimin e rruges deri tek rezervuari)		
NP - 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	<i>Sipas preventivit, Zerat, Shtrese stabilizanti t=10 cm, Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri</i>	A	0-20 milion
N.S- 9	Punime strukturore speciale.	<i>Sipas preventivit , Zerat, Struktura te holla monolite betoni C 20/25, t=20 cm</i>	A	0-20 milion
N.S-18	Punime topogjeodezike	<i>Sipas preventivit</i>	A	0-20 milio n

**2.3.3. a** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi - Profili Gjeoteknik - 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi - 1 (një)
- Inxhinier Topograf - 1 (një)
- Inxhinier Mekanik -1 (nje)

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohes së zbatimit të punimeve objekt kontrate,
- Diplomën përkatëse.
- Libreze pune.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarinimin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese inxhinieret e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë*

*paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.*

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

**2.3.3.b.** Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i shoqërisë, Përgjegjësin/Drejtues Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

**Argumentimi :** Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor Teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Përcaktimi i kërkeses për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin tere kohen e kryerjes se punimeve te nje drejtuesi teknik te shoqerise por dhe si orientim per nje person kontakti dhe ure lidhese mes mbikqyresit te punimeve dhe AK per problematiken qe do te haset gjate realizimit te punimeve.

Personeli i kerkuar	Punimet pjese e preventivit perkates
Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)	Eshte pergjegjes per zbatimin e projektit per rikonstruksionin e shkarkuesit te diges se rezervuarit, dhe punime hidrike prandaj eshte i domosdoshem prania e inxhinierit hidroteknik.
Inxhinier Ndertimi - Profili Gjeoteknik - 1 (nje)	Eshte i domosdoshem per shkak se ne preventive permbajne volume pune te cilat duhet te ndiqen nga inxhinieri gjeoteknik
Inxhinier Ndertimi - 1 (nje)	Inxhinieri i ndertimit eshte i nevojshem per te ndjekur te gjitha punimet e ndertimin per rikonstruksionin e shkarkuesit te diges.
Inxhinier Topograf - 1 (një)	Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi
Inxhinier Mekanik -1 (nje)	Eshte kerkuar ky inxhinier per arsye se mund te kete problematika gjate zbatimit te punimeve dhe mund te kete ndryshime dhe rregullime te cilave mund ti pergjigjet gjate zbatimit inxhinieri perkates. Si dhe eshte e domosdoshme asistenca e inxhinierit per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, të pajisur me diplomë/dëshmi ose certifikatë përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore , si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit , si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të disponoje 1 (një) punonjës i cili të jetë i pajisur me certifikatë "*Pergjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë*" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", VKM-se Nr. 312, dt 05.05.2010 "*Për sigurinë në kantier*", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certificate, Libreze pune si dhe të figurojnë në listpagesat e E-Sig.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 "*Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë*" i ndryshuar, ku për përmbushjen e këtij kushti të jete i shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme ose kontratë shërbimi të vlefshme (ne rastin kur OE nuk disponon nje te tille), Licensen lëshuar nga Urdhëri i Mjekut, Diplomësi dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave (ne rastin kur mjeku eshte pjese e stafit te OE)

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Karpentier 2 (dy)
- Mekanik / automekanik 2 (dy)
- Saldator 2 (dy)
- Montator 1 (nje)
- Manovrator 4 (kater)



- Shofer për drejtim mjeteve të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor 3 (tre).

Për punojesit e mesiperm duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Për teknik ndertimi, të paraqiten diplomat e shkolles së mesme profesionale .
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*", i ndryshuar.
- Dëshmi të Aftësisë Profesionale, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores "*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*", miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe referuar Kodit Rrugor.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atehere manovratorët, automakinistët dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listepagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt-marrëveshje.

Gjate fazes së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - "*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*", operatorët ekonomik për punonjësit e mesiperm **duhet të deklarojnë**: emër/mbiemer, profilin e punës, subjektin leshues të çertifikates/diplomes, Nipt (në rastin kur subjekti leshues i çertifikates/diplomes është privat).

Gjate fazes së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - "*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*", operatorët ekonomik për punonjësit manovrator dhe shofer, **duhet të deklarojnë**: emër/mbiemer, profilin e punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : "*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*", si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: "*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën,*

autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

**Argumentimi** : Kërkesat e mësipërme janë vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

**Kërkesa për certifikate për ”sigurinë dhe shëndetin në punë” është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqjes.**

Personeli i kerkuar	Punimet pjese e preventivit perkates
Teknik Ndërtimi 2 (dy)	Eshte i domosdoshem per te ndjekur nga afer ecurine e vazhdueshme te punes ne objekt gjate te gjitha fazave si; germimi, lidhja e hekurit, betonimi. Punimet ne preventiv te cilat kerkojne pranine e teknikut: Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir ( per hapjen dhe skarifikimin e rruges deri tek rezervuari), Struktura monolite betoni C 20/25, t=20cm, Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, per muret mbajtese etj.

Karpentier	2 (dy)	Jane te domosdoshem pasi ne preventivin fillestar parashikohen volume konkrete e perkatesisht ne zerat: Tombino me tuba betoni, shtrese zhavori Ø 300mm, Struktura monolite betoni C 20/25, t=20cm, Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, per muret mbajtese etj.
Saldator	2 (dy)	Jane te domosdoshem pasi ne preventivin fillestar parashikohen volume konkrete e perkatesisht ne zerat: Tombino me tuba betoni, shtrese zhavori Ø 300mm etj.
Mekanik / automekanik	2 (dy)	Jane te domosdoshem pasi kerkohej asistenca e kualifikuar per çdo defekt te mundshem te mjeteve qe do te perdoren gjate zbatimit te punimeve.
Montator 1 ( nje)		Eshte i domosdoshem per realizimin e zerave te montimit sipas preventivit.
Manovrator	4 (kater)	Jane te domosdoshem per punimet qe do te kryhen e perkatesisht ne zerat : Germim shkambi mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir ( per hapjen dhe skarifikimin e rruges deri tek rezervuari), etj
Shofer	3 (tre)	Jane te domosdoshem per punimet qe do te kryhen e perkatesisht ne zerat: Transport dheu auto 3 km, Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej minimalisht **50 (pesëdhjetë) persona** . Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Vërtetuar me:

- a.** Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën tre muajit e fundit.
- b.** Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën tre muajit e fundit, shoqëruar me formularet e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohej nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe

përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t’i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

**Argumentim:** Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimi. Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore te nevojshme për realizimin e kontratës ka bërë një përlllogaritje të saktë të numrit të punonjësve duke përcaktuar fillimisht orët e punës në bazë të analizës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”. Në këtë kontekst, autoriteti kontraktor ka përcaktuar numrin e punonjësve referuar një përlllogaritje të saktë të bërë referuar zërave të punimeve per objektin e prokurimit, orëve të punës (8 ore ne dite për cdo punonjës) afatit kohor te realizimit te kontrates si dhe shperndarjes se punes.

**2.3.6** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri dhe pajisje	Nr.	Njesia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-20 ton	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3 t	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrome (mjet teknologjik me goma)	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Minieskavator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc	1	cope	Ne pronesi ose me qera
RTV - Trasportier për mjete të renda	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Gjenerator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Saldatrice	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantieri	6	cope	Ne pronesi ose me qera
Vibrues betoni	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Karoca dore	10	cope	Ne pronesi ose me qera

Betoforma	200	m2	Ne pronesi ose me qera
Moto pompe uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autopompe	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Impiant betoni	1	cope	Ne pronesi/qera/kontrate furnizimi
Ngjeshes dheu	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Kokore	30	cope	Ne pronesi ose me qera
Jelek	30	cope	Ne pronesi ose me qera
Tabela sinjalizuese kantieri	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Komplet i ndihmes se shpejte	2	cope	Ne pronesi ose me qera

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pikë operatori duhet të paraqesë:

- i. Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).
- ii. Për mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit ne Republikën e Shqiperisë ose faturat tatimore te blerjes.
- iii. Për te gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.
- iv. Per mjetet e marra me qera qe shenohen ne rregjistra publik, duhet te paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracionii mjetit, si edhe çertifikata për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Kurse per mjetet që nuk shënohen ne regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre, aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- v. Per impiantin e betonit duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tij, kontrata noteriale e marrjes me qera ose furnizimit. Impianti i Betonit duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore lëshuar nga QKL.
- vi.

Disponimi i mjeteve dhe pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...*”.

Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës.

Nr	Nr. Man	Pershkrimi Punimeve	I Njesia	Sasia	
1	2.47/an	Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir ( përhapjen dhe skarifikimin e rruges deri tek rezervuari)	m3	1550	<b>Eskavator</b>
2	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, përhapur e ngjeshur me makiner	m2	7750	<b>Grejder</b>
	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	7750	<b>Grejder</b>
	3.355	Tombino me tuba betoni, shtrese zhavori Ø 300mm	m	40	<b>Autovinc</b>
	2.47/an	Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir	m3	349.2	<b>Eskavator</b>
	3.353	Mbushje me shkëmb te germuar me pare	m3	170	<b>Fadrome</b>

	3.158/3a	Transport dheu auto 3 km	m3	179.2	<b>Kamion, kamioncine</b>
	3.244	Struktura monolite betoni C 20/25, t=20cm	m3	192.6	<b>Betoniere, vibrator thellesie, Karoca dore, Moto pompe uji, Betoforma</b>
	3.633	Fugature llac cimento M - 50 cdo 3 ml	m2	14.1	
	3.166	F V ëaterstop tip RT 2000 10*20 & h/izolues tip rapid cement ne bashkimin e kampatave b/a, per fugat	ml	282	
	3.183/a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	118.8	<b>Grejder, fadrome etj.</b>
	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	16.164	<b>Kamion, etj</b>
	2.166/a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm, muri mbajtes	ton	1.26	<b>Kamion, etj</b>
	3.247	Struktura monolite betoni me çakell C 25/30, per muret mbajtese	m3	14	<b>Betoniere, vibrator thellesie, Karoca dore, Moto pompe uji, Betoforma</b>
	3.396/1	Mbushje me zhavorr pas mureve dhe mbushje per skarpaten	m3	42	<b>Grejder, fadrome etj.</b>
	2.37/5b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	217	<b>Kamion, kamioncine</b>

#### 2.4.Kritere të veçanta:

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

- Çertifikatë **ISO 39001-2012** mbi “Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor”, (e vlefshme) ose ekuivalente lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

\* Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

\*Janë të vlefshme edhe çertifikimet e lëshuara nga organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga Republika e Shqipërisë, të njohura dhe lëshuara sipas Standardeteve shqiptare të Drejtorisë së përgjithshme të Standardeve.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kërkesa për keto çertifikata është bere pasi janë të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

**ISO 9001:2015** - Kjo çertifikatë mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi, e cila mundëson implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës.

**ISO 45001: 2018** – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

**ISO 14001-2015**- Është standarti më i përdorur në botë për sistemet e menaxhimit të mjedisit. Rikonstrukcioni i objektit konkret, përveçse kërkojnë një kapacitet me makineri kanë edhe një ndikim në mjedis për shkak të kushteve në të cilat realizohen si ndotja e ajrit nga pluhurat e kantierit ndotja akustike



dhe mjedisore nga makinerite etj. Për këtë arsye cdo operator ekonomik duhet të jetë i certifikuar për menaxhimin e ambientit. Është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

**ISO 39001-2012** “Për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor” kërkohet që Operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë besueshmërinë e nevojshme në menaxhimin e situatave të cilat do të krijohen në momentet e punimeve që do të realizohen në rrugë. Gjate zbatimit të punimeve duhet të merren masa për vijueshmëri normale të trafikut. Theksojme se është shumë e rëndësishme që kontraktori të zbatohet me rigorizitet të gjitha kushtet e sigurimit teknik të zbatimit të punimeve. Kjo verteton se operatorët ekonomikë *të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojnë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor*. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit ku kemi kryerjen e punimeve në rrugë automobilistike ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë si nga automjetet ashtu dhe nga këmbësorët, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që ofertuesit të jenë të pajisur me këtë certifikim.

**2.4.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar për çdo zë pune.

Grafiku i punimeve dhe afati precaktuar janë pjesë e dokumentacionit të tenderit të hartuar dhe kontrolluar nga struktura teknike e posaçme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është precaktuar bazuar në nenin 79, të Ligjit nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 39, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Gjithashtu në nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit”

**2.4.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshte:

- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim ruajtje dhe transport i mbetjeve inerte”.
- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.A për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

**Argumentimi:** Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në precaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” **ku transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B)** sipas ligjit nr. 10 081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, nga institucioni kompetent që lëshon këto liçenca (Qendra Kombëtare e Licencimit), në përputhje me precaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr.538, datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet

*që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.*

Kërkesa e mësipërme për Kodi III.2.B, është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 dhe 4, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Po ashtu, referuar natyrës së punimeve që do të kryhen, në zbatim nenit 25 të ligjit nr. 10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar), nenit 6 pika 1 dhe nenit 20 pika 4 të ligjit nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis” (i ndryshuar), **duke qënë se Op. Ek. Pjesëmarrës, në cilësinë e zbatuesit të punimeve duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomik duhet të jenë të licencuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Kodi III.2.A) në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave me Nr. 538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”**

**2.3.4** Operatori ekonomik në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përketes të publikuar në DST, për listen e artikujve, si me poshtë:

- a) Hekur
- b) Waterstop tip RT 2000

#### **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:**

1. Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje Bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëebsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Ne rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
2. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listen e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
3. Deshmi të testimeve zyrtare të kryera dhe të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi që vërtetojnë pajtueshmerine e materialeve (sipas listes së mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

4. Të gjitha materialet e mësipërme duhet të jenë sipas Standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO 9001 dhe / ose të pajisur me Çertifikatë Konformiteti CE dhe çertifikate origjinale nga shtetet e Bashkimit Europian.

Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marre përsipër të furnizojë sipas kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

**Argumentimi:** Paraqitja e këtyre dokumenteve është vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qënë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë edhe me materiale dhe pajisje që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimeve të kryera**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Në nenin 40 pika 6/ b dhe c të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

**b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose**

**c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”**

Gjithashtu në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Bazuar në dokumentacionin e projektit objekt prokurimi, ku ndër të tjerash janë dërguar dhe *Specifikimet Teknike* për punimet që do të kryhen, të cilat janë hartuar nga një shoqëri e licensuar në projektim, duke qënë se këto specifikime teknike plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit **nr.162/2020, datë 23.12.2020** “Për Prokurimin publik”, dhe nenin 39 pika 2 të Vendimin e Këshillit të Ministrave **Nr. 285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), njësia e prokurimit kreu miratimin e specifikimeve teknike për punimet objekt prokurimi.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.
- Data e hapjes dhe e zhvillimit të procedurës së prokurimit do të jetë: \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024 Ora \_\_\_\_:\_\_\_\_ në mënyrë elektronike në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.**

**NJËSIA E PROKURIMIT**